

“Ye Are My Friends”

By Elder David L. Buckner
Of the Seventy

“Ju Jeni Miqtë e Mi”

Nga Plaku Dejvid L. Bakner,
i Të Shtatëdhjetëve

October 2024 general conference

The Savior’s declaration “ye are my friends” is a clarion call to build higher and holier relationships among all of God’s children.

In a world filled with contention and division, where civil discourse has been replaced with judgment and scorn, and friendships are defined by -isms and -ities, I have come to know that there is a clear, simple, and divine example we can look to for unity, love, and belonging. That example is Jesus Christ. I testify that He is the great unifier.

We Are His Friends

In December of 1832, as “appearances of troubles among the nations” were becoming “more visible” than at any time since the organization of the Church, Latter-day Saint leaders in Kirtland, Ohio, gathered for a conference. They prayed “separately and vocally to the Lord to reveal his will unto [them].” In acknowledgement of the prayers of these faithful members during times of intense trouble, the Lord comforted them, addressing the Saints three times with two powerful words: “my friends.”

Jesus Christ has long called His faithful followers His friends. Fourteen times in the Doctrine and Covenants, the Savior uses the term friend to define a sacred and cherished relationship. I am not talking about the word friend as the world defines it—subject to social media followers or “likes.” It cannot be captured in a hashtag or a number on Instagram or X.

Deklarata e Shpëtimtarit “ju jeni miqtë e mi” është një thirrje trumbetuese për të ndërtuar marrëdhënie më të larta dhe më të shenjta mes gjithë fëmijëve të Perëndisë.

Në një botë të mbushur me grindje dhe përçarje, ku ligjërimi civil është zëvendësuar me gjykimin e përbuzjen dhe miqësitë përcaktohen nga botëkuptime dhe ideologji të ngjashme, kam arritur të di se ekziston një shembull i qartë, i thjeshtë dhe hyjnor tek i cili mund ta shohim bashkimin, dashurinë dhe përkatësinë. Ai shembull është Jezu Krishti. Dëshmoj se Ai është bashkuesi i madh.

Ne Jemi Miqtë e Tij

Në dhjetor të vitit 1832, ndërsa “pamjet e trazirave midis kombeve” po bëheshin “më të dukshme” në krahasim me çdo kohë tjetër që nga organizimi i Kishës, udhëheqësit e shenjtoreve të ditëve të mëvonshme në Kirtland të Ohajos u mbledhën për një konferencë. Ata iu lutën “Zotit veçan dhe me zë për t’u zbuluar atyre vullnetin e tij”. Si pranim i lutjeve të këtyre anëtarëve besnikë gjatë kohëve të shqetësimit të madh, Zoti i ngushëlloi ata, duke iu drejtuar shenjtoreve tri herë me dy fjalë të fuqishme: “miqtë e mi”.

Jezu Krishti i ka quajtur prej kohësh miq ndjekësit e Tij besnikë. Katërmëdhjetë herë te Doktrina e Besëlidhje, Shpëtimtari përdor termin miq për të përkufizuar një marrëdhënie të shenjtë dhe të dashur. Nuk po flas për fjalë miksiç e përkufizon bota, në varësi të ndjekësve në rrjetet sociale apo “pëlqimeve”. Ajo fjalë nuk mund të paraqitet nga një thurje [hashtag] apo nga një numër ndjekësish në Instagram ose në

Admittedly, as a teenager, I remember dreaded conversations when I heard those painful words “Hey, can we just be friends?” or “Let’s just stay in the friend zone.” Nowhere in holy writ do we hear Him say, “Ye are just my friends.” Rather, He taught that “greater love hath no man than this, that a man lay down his life for his friends.” And “ye are they whom my Father hath given me; ye are my friends.”

The sentiment is clear: the Savior numbers each of us and watches over us. This watchcare is not trivial or insignificant. Rather, it is exalting, elevating, and eternal. I see the Savior’s declaration “ye are my friends” as a clarion call to build higher and holier relationships among all of God’s children “that we may be one.” We do this as we come together seeking both opportunities to unite and a sense of belonging for all.

We Are One in Him

The Savior beautifully demonstrated this in His call to “come, follow me.” He drew upon the gifts and individual attributes of a diverse group of followers to call His Apostles. He called fishermen, zealots, brothers known for their thunderous personalities, and even a tax collector. Their belief in the Savior and desire to draw unto Him united them. They looked to Him, saw God through Him, and “straightway left their nets, and followed Him.”

I too have seen how building higher and holier relationships brings us together as one. My wife, Jennifer, and I were blessed to raise our five children in New York City. There in that busy metropolis, we formed precious and sacred relationships with neighbors, school friends, business associates, faith leaders, and fellow Saints.

In May of 2020, just as the world was grappling with the spread of a global pandemic, members of the New York City Commission of Religious Leaders met virtually in an abruptly called meeting. There was no agenda. No special guests. Just a request to come together and discuss the challenges we were all facing as faith leaders. The Centers for Disease Control had

platformen X.

Pa dyshim, kur isha adoleshent, më kujtohen bisedat të cilave iu druhesha kur dëgjoja ato fjalë të dhembshme nga vajzat që më pëlqenin: “Ej, a mund të jemi thjesht miq?” ose “Le të mbetemi thjesht miq”. Askund në shkrimin e shenjtë nuk e dëgjojmë Atë të thotë: “Ju jeni thjesht miqtë e mi”. Përkundrazi, Ai dha mësim se “askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij”. Dhe “ju jeni ata që Ati im m’i ka dhënë; ju jeni miqtë e mi”.

Ndjenja është e qartë: Shpëtimtari është në dijeni për secilin prej nesh dhe na vëzhgon. Ky kujdes i vëmendshëm nuk është i parëndësishëm ose i papërfillshëm. Përkundrazi, ai është ekzaltues, lartësues dhe i përjetshëm. Deklaratën e Shpëtimtarit “ju jeni miqtë e mi” e shoh si një thirrje trumbetuese për të ndërtuar marrëdhënie më të larta dhe më të shenjtames gjithë fëmijëve të Perëndisë “që ne të mund të jemi një”. Ne e bëjmë këtë ndërsa mblihdemi së bashku duke kërkuar mundësi për t’u bashkuar si dhe një ndjesi përkatësie për të gjithë.

Ne Jemi Një në Të

Shpëtimtari e demonstroi bukur këtë gjë në thirrjen e Tij: “Eja e më ndiq”. Ai u mbështet te dhuntitë dhe cilësitë individuale të një grupi të ndryshëm ndjekësish për të thirrur Apostujt e Tij. Ai thirri peshkatarë, zelota, vëllezër të njohur për personalitetin e tyre si bubullimë, madje edhe një tagrambledhës. Besimi i tyre te Shpëtimtari dhe dëshira për t’u afruar tek Ai, i bashkoi ata. Ata e vështruan, panë Perëndinë përmes Tij dhe “i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën”.

Edhe unë kam parë se si krijimi i marrëdhënieve më të larta e më të shenjta na bashkon në një. Bashkëshortja ime, Xheniferi, dhe unë u bekuam t’i rritnim të pesë fëmijët tanë në qytetin e Nju-Jorkut. Atje, në atë metropol të ngarkuar, ne krijuam marrëdhënie të çmuara dhe të shenjta me fqinjët, miqtë nga shkolla, bashkëpunëtorët në sipërmarrje, udhëheqësit në besim dhe bashkëshenjtorët.

Në maj të vitit 2020, pikërisht kur bota po përballej me përhapjen e një pandemie botërore, anëtarët e Komisionit të Udhëheqësve Fetarë të Qytetit të Nju-Jorkut u mbledhën nëpërmjet internetit në një mbledhje të thirrur papritmas. Nuk kishte rend dite. Asnjë të ftuar të veçantë. Vetëm një kërkesë për t’u mbledhur së bashku dhe për të diskutuar mbi sfidat me të cilat ne të

just reported that our city was the epicenter of the COVID-19 pandemic in the United States. This meant no more gathering. No more coming together.

For these religious leaders, removing the personal ministry, the congregational gathering, and the weekly worship was a devastating blow. Our small group—which included a cardinal, reverend, rabbi, imam, pastor, monsignor, and an elder—listened to, consoled, and supported one another. Instead of focusing on our differences, we saw what we had in common. We spoke of possibilities and then probabilities. We rallied and responded to questions about faith and the future. And then we prayed. Oh, how we prayed.

In a richly diverse city filled with complexity and colliding cultures, we saw our differences dissipate as we came together as friends with one voice, one purpose, and one prayer.

No longer were we looking across the table at each other but heavenward with each other. We left each subsequent meeting more united and ready to pick up our “shovels” and go to work. The collaboration that resulted and the service rendered to thousands of New Yorkers taught me that in a world calling for division, distance, and disengagement, there is always much more that unites us than divides us. The Savior pled, “Be one; and if ye are not one ye are not mine.”

Brothers and sisters, we must stop looking for reasons to divide and instead seek opportunities to “be one.” He has blessed us with unique gifts and attributes that invite learning from one another and personal growth. I often told my university students that if I do what you do and you do what I do, we don’t need each other. But because you don’t do what I do and I don’t do what you do, we do need each other. And that need brings us together. To divide and conquer is the adversary’s plan to destroy friendships, families, and faith. It is the Savior who unites.

We Belong to Him

One of the promised blessings of “becom-

gjithë po përballeshim si udhëheqës besimesh fetare. Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve sapo kishte raportuar se qyteti ynë ishte epiqendra e pandemisë nga virusi COVID-19 në Shtetet e Bashkuara. Kjo nënkuptonte se nuk do të kishte më grumbullime. Nuk mund të bëheshim më bashkë.

Për këta udhëheqës fetarë, heqja e shërbesës vetjake, e grumbullimit si bashkësi dhe e adhurimit javor ishte një goditje shkatërruese. Grupi ynë i vogël, i cili përfshinte një kardinal, një të përnderuar, një rabi, një imam, një pastor, një monsignor dhe një plak, e dëgjoi, e ngushëlloi dhe e përkrahu njëri-tjetrin. Në vend që të përquendroheshim te ndryshimet tona, ne pamë atë që kishim të përbashkët. Folëm për mundësitë dhe më pas gjasat. U mbledhëm dhe iu përgjigjëm pyetjeve rreth besimit dhe së ardhmes. Më pas u lutëm. O, me sa zjarr u lutëm.

Në një qytet tejet të larmishëm, të mbushur me ndërlikime dhe kultura që përplasen, pamë që ndryshimet tona u davaritën ndërsa u bashkuam si miq me një zë, një qëllim dhe një lutje të vetme.

Nuk po e vështronim më njëri-tjetrin nga ana e kundërt e tryezës, por po vështronim së bashku drejt qiellit. Nga çdo mbledhje pasuese, ne u larguam më të bashkuar dhe të gatshëm për të marrë “lopatat” në dorë e për t’iu futur punës. Bashkëpunimi që pasoi dhe shërbimi që iu dha mijëra njujorkezëve, më mësoi se në një botë që kërkon përçarje, largësi dhe mospërfshirje, ka gjithmonë shumë më tepër gjëra që na bashkojnë sesa që na ndajnë. Shpëtimtari u përgjyera: “Jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë”.

Vëllezër dhe motra, ne duhet të ndalojmë së kërkuari arsye për t’u përçarë dhe të kërkojmë mundësi për të “[qenë] një”. Ai na ka bekuar me dhunti dhe cilësi të pashoqe që na ftojnë të mësojmë nga njëri-tjetri dhe të rritemi nga ana vetjake. U thosha shpesh studentëve të mi se, në qoftë se unë bëj atë që bëni ju dhe ju bëni atë që bëj unë, ne nuk kemi nevojë për njëri-tjetrin. Por për shkak se ju nuk bëni atë që bëj unë dhe unë nuk bëj atë që bëni ju, kemi nevojë për njëri-tjetrin. Kjo nevojë na bën bashkë. Përçarja dhe sundimi është plani i kundërshtarit për të shkatërruar miqësitë, familjet dhe besimin. Është Shpëtimtari Ai që bashkon.

Ne i Përkasim Atij

Një nga bekimet e premtuara të “bërjes një”

ing one” is a powerful sense of belonging. Elder Quentin L. Cook taught that “the essence of truly belonging is to be one with Christ.”

On a recent visit with my family to the West African country of Ghana, I was enamored with a local custom. Upon arriving at a church or home, we were greeted with the words “you are welcome.” When food was served, our host would announce, “You are invited.” These simple greetings were extended with purpose and intentionality. You are welcome. You are invited.

We place similar sacred declarations on our meetinghouse doors. But the sign Visitors Welcome is not enough. Do we warmly welcome all who come through the doors? Brothers and sisters, it is not enough to just sit in the pews. We must heed the Savior’s call to build higher and holier relationships with all of God’s children. We must live our faith! My father often reminded me that simply sitting in a pew on Sunday doesn’t make you a good Christian any more than sleeping in a garage makes you a car.

We must live our life so that the world does not see us but sees Him through us. This does not take place only on Sundays. It takes place at the grocery store, the gas pump, the school meeting, the neighborhood gathering—all places where baptized and unbaptized members of our family work and live.

I worship on Sunday as a reminder that we need each other and together we need Him. Our unique gifts and talents that differentiate us in a secular world unite us in a sacred space. The Savior has called upon us to help one another, lift one another, and edify each other. This is what He did when He healed the woman with an issue of blood, cleansed the leper who pled for His mercy, counseled the young prince who asked what more he could do, loved Nicodemus, who knew but faltered in his faith, and sat with the woman at the well, who did not fit the custom of the day but to whom He declared His messianic mission. This to me is church—a place of gathering and recovery, repair and refocus. As President Russell M. Nelson has taught: “The gospel net is the largest net in the world. God has invited all to come unto Him. ... There is room for everyone.”

është një ndjesi e fuqishme e përkatësisë. Plaku Kuentin L. Kuk dha mësim se “thelbi i përkatësisë me të vërtetë, është që të jemi një me Krish-tin”.

Në një vizitë të fundit me familjen time në Ganë, shteti i Afrikës Perëndimore, u dashurova me një zakon vendas. Me të mbërritur në një kishë ose në shtëpi, na përshëndetnin me fjalët “Mirë se vini”. Kur shërbehej ushqimi, i zoti i shtëpisë shpallte: “Jeni të ftuar”. Këto përshëndetje të thjeshta bëheshin me qëllim dhe dashje. Mirë se vini! Jeni të ftuar.

Ne vendosim deklarata të ngjashme të shenjta në dyert e shtëpive tona të mbledhjeve. Por shenja “Mirë se Vini Vizitorë” nuk mjafton. A i mirëpresim ngrohtë të gjithë ata që hyjnë përmes dyerve? Vëllezër dhe motra, nuk mjafton vetëm të ulemi nëpër stola. Ne duhet t’ia vëmë veshin thirrjes së Shpëtimtarit për të krijuar marrëdhënie më të larta dhe më të shenjta me të gjithë fëmijët e Perëndisë. Duhet ta jetojmë besimin tonë! Babai im më kujtonte shpesh se ulja në një stol të dielën mund të të bëjë një të krishterë të mirë po aq sa fjetja në një garazh mund të të kthejë në një makinë.

Ne duhet ta jetojmë jetën në mënyrë që bota të mos na shohë ne, por të shohë Atë nëpërmjet nesh. Kjo nuk ndodh vetëm të dielave. Ndodh në dyqanin e ushqimeve, në një pikë karburanti, në mbledhjen e shkollës, mbledhjen e lagjes së banimit, në të gjitha vendet ku punojnë dhe jetojnë anëtarët e pagëzuar dhe të papagëzuar të familjes sonë.

Unë adhuroj të dielave si një kujtesë se kemi nevojë për njëri-tjetrin dhe së bashku kemi nevojë për Të. Dhuntitë dhe talentet tona të pasqojnë që na dallojnë në një botë laike, na bashkojnë në një hapësirë të shenjtë. Shpëtimtari na ka bërë thirrje që ta ndihmojmë njëri-tjetrin, ta lartësojmë moralisht njëri-tjetrin dhe ta udhëzojmë njëri-tjetrin. Kështu bëri Ai kur shëroi gruan me fluks gjaku, kur pastroi lebrasin që u përgjyera për mëshirën e Tij, kur këshilloi të riun pasanik, i cili e pyeti se çfarë mund të bënte më tepër, kur e dëshi Nikodemin që e dinte se kush qe Ai, por u lëkund në besim, dhe kur u ul me gruan te pusi, gjë e cila nuk i përshtatej zakonit të kohës, por së cilës Ai i shpalli misionin e Tij si Mesia. Kjo për mua është kisha, një vend grumbullimi dhe shërimi, ndreqjeje dhe ripërqendrimi. Siç na ka mësuar Presidenti Rasëll M. Nelson: “Rrjeta e ungjillit është rrjeta më e gjerë në botë. Perëndia i

Some may have had experiences that make you feel you do not belong. The Savior's message to you and me is the same: "Come unto me, all ye that labour and are heavy laden, and I will give you rest." The gospel of Jesus Christ is the perfect place for us. Coming to church offers the hope of better days, the promise that you are not alone, and a family who needs us as much as we need them. Elder D. Todd Christofferson affirms that "being one with the Father, Son, and Holy Spirit is without doubt the ultimate in belonging." To any who have stepped away and are seeking a chance to return, I offer an eternal truth and invitation: You belong. Come back. It is time.

In a contentious and divided world, I testify that the Savior Jesus Christ is the great unifier. May I invite each of us to be worthy of the Savior's invitation to "be one" and to boldly declare, as He did, "Ye are my friends." In the sacred name of Jesus Christ, amen.

ftontë gjithëqë të vijnë tek Ai. ... Ka vend për çdo njeri."

Disa prej jush mund të kenë pasur përvoja që ju bëjnë të ndieni se nuk keni përkatësi. Mesazhi i Shpëtimtarit për ju dhe mua është i njëjtë: "Eja-ni tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju jap çlodhje". Ungjilli i Jezu Krishtit është vendi i përkryer për ne. Ardhja në kishë ofron shpresën për ditë më të mira, premtimin se nuk jeni vetëm dhe na ofron një familje që ka nevojë për ne po aq sa kemi ne nevojë për të. Plaku D. Tod Kristoferson, pohon se "të qenit një me Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë është pa dyshim lloji më i mirë i përkatësisë". Kujtdo që është larguar dhe po kërkon një mundësi për t'u kthyer, unë i ofroj një të vërtetë të përjetshme dhe ftesë: Ju përkisni. Kthehuni. Kjo është koha.

Në një botë plot grindje dhe të përçarë, unë dëshmoj se Shpëtimtari Jezu Krisht është bashkuesi i madh. E ftoj secilin prej nesh që të jetë i denjë për ftesën e Shpëtimtarit që të "[em] i një]" dhe për të shpallur me guxim siç bëri Ai: "Ju jeni miqtë e mi". Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.